



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1711/7 prot

Datë 16.08.2023

V E N D I M

Nr. 768/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.08.2023 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Agro-Korani” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-73052-06-20-2023, me objekt: “*Loti 2 “Blerje lule sezonale”*” me fond limit 2.083.250 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë.

Ankimues: “Albgarden” SHPK.
Lagja Skenderbeg, Godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë-Shkodër, Km 1, Tiranë.

Subjekte të Interesuar: “Agro-Korani” SHPK
Ndërtesë 1 Katëshe, pranë Urës së Draxhit, Shtodhër Helmës, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.06.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73052-06-20-2023, me objekt: “Loti 2 “Blerje lule sezonale”” me fond limit 2.083.250 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Në datën 13.07.2023, operatori ekonomik “Albgarden” SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave si vijon:

- | | |
|-----------------------|-----------------------------|
| 1. “Agro-Korani” SHPK | 1.504.850 lekë, kualifikuar |
| 2. “AlbGarden” SHPK | 1.636.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “A.M.E 2020” SHPK | 1.854.550 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 14.07.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.4. Në datën 17.07.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1711/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3273 e operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Agro-Korani” SHPK. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Operatorit ekonomik “AGRON-KORANI” sh.p.k., me NUIS L13329801V ne dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT dhe deklaratës për stafin-teknik) dhe 5 (pesë) punonjës e paraqitur të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte” që vërtetohen me Certifikata profesionale, nuk vërteton se plotëson: Operatorit ekonomik “AGRON-KORANI” sh.p.k nuk plotëson kërkesën e pikës 2.2.3 Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve te fundit nga data e shpalljes se procedurës së prokurimit: pika 2 lidhur me 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte” që vërtetohen me Certifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj te shoqëruar me kontrate pune. Për plotësimin e këtyre kriterëve shoqëria ka deklaruar se punonjësit e paraqitur janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekt i cili nuk ka asnjë licencë aktive sipas ligjit dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh”. Lehtesisht e verifikuar ne Eëb-in e QKB, nga ku rezulton se ky subjekt nuk ka licenca aktive, këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 441/2020 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara. Ekstrakt i vendimit 441/2022.

Ne pretendojmë se operatori ekonomik “AGRO – KORANI” sh.p.k nuk e përmbush kriterin e kualifikimit për procedure me objekti “Plehra kimike,furnitura veterinare,farëra,fidanë e të tjera produkte agrokulturore” Loti 2 Blerje lule sezonale konkretisht kriterin 2.2 Kapaciteti Teknik, 2.2.3 Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve te fundit nga data e shpalljes se procedurës së prokurimit:

5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte” që vërtetohen me Certifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj të shoqëruar me kontrate pune.

Në këto kushte, në mospërbushjen e kriterit mësipër cituar, do të arrinim në përfundimin e arsyeshëm se operatori ekonomik “AGRO – KORANI” sh.p.k., nuk ka kapacitete për realizimin me sukses të kësaj kontrate. Për këto arsye kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik “AGRO – KORANI” sh.p.k., nga kjo procedurë prokurimi edhe për mospërbushje të këtij kriteri.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1711/2 date 18.07.2023, lidhur me kriteret kualifikuese për të cilat pretendohet se nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik “Agro-Korani ” SHPK.

II.6. Në datën 28.07.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1711/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1003/18 prot., datë 24.07.2023 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, drejtuar operatorit ekonomik ankimues, për dijeni KPP-së. Referuar kësaj shkrese rezulton se ankesa e operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK, është refuzuar nga ky Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.

II.7. Me qëllim shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, me anë të shkrësës nr.1711/5 prot., datë 08.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtuar autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion si më poshtë: “[...] Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar informacion lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, por mungon dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Agro-Korani” SHPK për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit që lidhen me deklaratat e bëra nga ky i fundit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte”, dhe që pretendohet nga ankimuesit se nuk plotësohen nga kjo shoqëri.

Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë të paraqitur nga shoqëria “Agro-Korani” SHPK që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte”.”

II.8. Në datën 14.08.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1711/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1362/1 prot., datë 10.08.2023 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, ku konstatohet se bashkëlidhur kësaj shkrese është dorëzuar dokumentacioni i paraqitur pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Agro – Korani” SHPK.

II.9. Në datën 02.08.2023, protokolluar pranë KPP me nr.1711/4 prot., operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK, si operator ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka dorëzuar argumente jashtë afateve të parashikuara në nenin 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro – Korani” SHPK me arsyetimin se “Operatorit ekonomik “AGRON-KORANI” sh.p.k., me NUIS L13329801V ne dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT dhe deklaratës për stafin-teknik) dhe 5 (pesë) punonjës e paraqitur të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte” që vërtetohen me Certifikata profesionale, nuk vërteton se plotëson: Operatorit ekonomik “AGRON-KORANI” sh.p.k nuk plotëson kërkesën e pikës 2.2.3 Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve te fundit nga data e shpalljes se procedurës së prokurimit: pika 2 lidhur me 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte” që vërtetohen me Certifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj te shoqëruar me kontrate pune.

Për plotësimin e këtyre kriterëve shoqëria ka deklaruar se punonjësit e paraqitur janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekt i cili nuk ka asnjë licencë aktive sipas ligjit dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh”. Lehtesisht e verifikuar ne Ëeb-in e QKB, nga ku rezulton se ky subjekt nuk ka licenca aktive, këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 441/2020 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara. Ekstrakt i vendimit 441/2022.

Ne pretendojmë se operatori ekonomik “AGRO – KORANI” sh.p.k nuk e përmbush kriterin e kualifikimit për procedure me objekti “Plehra kimike,furnitura veterinare,farëra,fidanë e të tjera produkte agrokulturore” Loti 2 Blerje lule sezonale konkretisht kriterin 2.2 Kapaciteti Teknik, 2.2.3 Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve te fundit nga data e shpalljes se procedurës së prokurimit:

5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte” që vërtetohen me Certifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj te shoqëruar me kontrate pune.

Në këto kushte, ne mospërmbushjen e kriterit mësipër cituar, do të arrinim në përfundimin e arsyeshëm se operatori ekonomik “AGRO – KORANI” sh.p.k., nuk ka kapacitete për realizimin

me sukses të kësaj kontrate. Për këto arsye kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik “AGRO – KORANI” sh.p.k., nga kjo procedurë prokurimi edhe për mospërbushje të këtij kriteri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.3 të “Kapacitetit teknik”, të dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshte vijon:

2.2.3 Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve te fundit nga data e shpalljes se procedurës së prokurimit:

- 1 (një) Agronom te shoqëruar me diplomë, kontrate pune.
- 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për” punime në fidanishte”që vërtetohen me çertifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj te shoqëruar me kontrate pune.

Bashkëlidhur listëpagesa e cdo muaji te Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numër E-SIG 025/a.1) për periudhën e 3 muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe natyrën e mallit që kërkohet të furnizohet. Nevoja për agronom dhe të paktën 3 punonjës të kualifikuar për punime në fidanishte, është e lidhur ngushtësisht me natyrën dhe artikujt objekt kontrate. Mungesa e këtij stafi potencialisht mund të çojë në dështimin e kontratës së furnizimit, ose në rastin më pak të keq do të rezultojë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe furnizimin e mallit me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor teknik është minimal dhe është përcaktuar në raport të ngushtë me natyrën specifike të mallit objekt kontrate.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur;

III.1.3. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin**

përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në cdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.6. Në nenin 40, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “5.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.1.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro - Korani” SHPK, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili nga verifikimi konstatohet se është plotësuar sipas Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit.

III.1.8. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se operatori ekonomik “Agro - Korani”, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, në lidhje me punonjësit ka deklaruar se disponon 1 Agronome (Znj. A.Z), një inxhinier pyjesh (z. E.N), si dhe 6 punonjës fidanishte (Dh.K; L.B.; B.H; I.H; O.K; F.M).

III.1.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që “*Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit:*

- 1 (një) Agronom të shoqëruar me diplomë, kontrate pune.*
- 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për” punime në fidanishte” që vërtetohen me çertifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj të shoqëruar me kontrate pune.*

Bashkëlidhur listëpagesa e cdo muaji të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numër E-SIG 025/a.1) për periudhën e 3 muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit.”

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në pjesën III, është plotësuar pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve, ku konstatohet, se janë deklaruar stafi i disponueshëm nga operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK.

Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “AlbGarden” SHPK, për skuafikimin e operatorit ekonomik “Agro - Korani” SHPK, me anë të shkresës nr.1711/5 prot., datë 08.08.2023, me përmbajtje “[...] Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar informacion lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, por mungon dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Agro-Korani” SHPK për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit që lidhen me deklaratat e bëra nga ky i fundit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte”, dhe që pretendohet nga ankimuesit se nuk plotësohen nga kjo shoqëri.

Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë të paraqitur nga shoqëria “Agro-Korani” SHPK që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte”, i kërkoi autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzohet pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK, i renditur i pari, që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte”.

Në datën 14.08.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1711/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1362/1 prot., datë 10.08.2023 me objekt: “Kthim përgjigje”, ku konstatohet se bashkëlidhur kësaj shkrese është dorëzuar dokumentacioni i paraqitur pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Agro – Korani” SHPK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se operatori ekonomik “Agro – Korani” SHPK, në përmbushje të kriterit 2.23 në dokumentet e tenderit, për punonjësit e deklaruar ka dorëzuar Vërtetim Nr. T08668983, datë 09.07.2023 (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin – E-SIG 02/a), ku rezulton se “...deri në datën 09.07.2023, rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 0 lekë detyrime...”. Gjithashtu, operatori ekonomik “Agro - Korani” SHPK, ka dorëzuar Listëpagesat për muajt Janar - Maj 2023, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Gjithashtu, në përmbushje të pikës 2.2.3 të “Kapacitetit teknik”, në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, nga dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstatohet se operatori ekonomik “Agro – Korani” ka dorëzuar:

- Kontratë pune datë 03.03.2020 midis punëdhënësit shoqërisë “Agro – Korani” SHPK dhe punëmarrësit znj. DH.K me profesion, specialist për punime në fidanishte; Certifikatë trajnimi, nr. AQS/T/S51672019, në emër të Znj. Dh. K, për trajnimin me temë “Kurs trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”, lëshuar në datë 28.02.2019 nga AQSCERT SHPK.
- Kontratë pune datë 03.03.2020 midis punëdhënësit shoqërisë “Agro – Korani” SHPK dhe punëmarrësit znj. L.B me profesion specialist për punime në fidanishte; Certifikatë trajnimi, nr. AQS/T/S51662019, në emër të Znj. L.B, për trajnimin me temë “Kurs trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”, lëshuar në datë 28.02.2019 nga AQSCERT SHPK.
- Kontratë pune datë 03.03.2020 midis punëdhënësit shoqërisë “Agro – Korani” SHPK dhe punëmarrësit z. B.H me profesion specialist për punime në fidanishte; Certifikatë trajnimi, nr. AQS/T/S51642019, në emër të Z. B.H, për trajnimin me temë “Kurs trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”, lëshuar në datë 28.02.2019 nga AQSCERT SHPK.
- Kontratë pune datë 03.03.2020 midis punëdhënësit shoqërisë “Agro – Korani” SHPK dhe punëmarrësit z. I.H me profesion specialist për punime në fidanishte; Certifikatë trajnimi, nr. AQS/T/S51632019, në emër të Z. I.H, për trajnimin me temë “Kurs trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”, lëshuar në datë 28.02.2019 nga AQSCERT SHPK.
- Kontratë pune datë 03.03.2020 midis punëdhënësit shoqërisë “Agro – Korani” SHPK dhe punëmarrësit znj. O.K me profesion specialist për punime në fidanishte; Certifikatë trajnimi, nr. AQS/T/S51622019, në emër të Znj. O.K, për trajnimin me temë “Kurs trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”, lëshuar në datë 28.02.2019 nga AQSCERT SHPK.
- Kontratë pune datë 03.03.2020 midis punëdhënësit shoqërisë “Agro – Korani” SHPK dhe punëmarrësit z. F.M me profesion specialist për punime në fidanishte; Certifikatë trajnimi, nr. AQS/T/S69172021, në emër të Z. F.M, për trajnimin me temë “Kurs trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”, lëshuar në datë 04.03.2021 nga AQSCERT SHPK;

III.1.10. Në ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3 të tij përcakton se: *“Arsimi dhe formimi profesional ka për mision: a) të zhvillojë kompetenca personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik; b) të ofrojë arsim dhe formim profesional në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencës e të teknologjisë, me kërkesat e tregut të punës në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe me kulturën e traditën kombëtare; c) të sigurojë përputhshmëri ndërkombëtare të dokumenteve certifikuese të lëshuara.”* Ndërsa në pikën 17 të nenit 4 të po këtij ligji thuhet se: *“Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.*

III.1.11. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2.3 e Kapacitetit Teknik, të dokumentave të procedurës së prokurimit si më sipër cituar, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri që ofertuesi duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve te fundit nga data e shpalljes se procedurës së prokurimit:

- 1 (një) Agronom te shoqëruar me diplomë, kontrate pune.

□ 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte” që vërtetohen me çertifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj të shoqëruar me kontrate pune.

Bashkëlidhur listëpagesa e cdo muaji të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numër E-SIG 025/a.1) për periudhën e 3 muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit.

Pra në këtë rast, lidhur me punonjësit me profesionin për “punime në fidanishte”, përveçse të figurojnë në listëpagesa për periudhën e kërkuar dhe të ketë kontratë pune, gjithashtu duhet detyrimisht që këta punonjës të jenë të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në fidanishte” që vërtetohen me çertifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj.

III.1.12. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Agro - Korani” sh.p.k rezulton se për punonjësit e mësipërm ka paraqitur Certifikata Trajnimi lëshuar nga AQSCERT për “Kurs Trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP me qëllim shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, duke qenë se certifikatat për punonjësit e mësipërm janë lëshuar nga Aqscert SHPK, verifikoi në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”, për subjektin AQScert SHPK objektin e aktivitetit të këtij të fundit. Konkretisht, nga verifikimi i këtij ekstrakti konstatohet se në datën 05.10.2020, objekti i aktivitetit është ndryshuar si më poshtë: “**Objekti ishte** (“Vlerësimin e konformitetit të implementimit të standarteve nderkombetare ISO. Trajnime për standartet nderkombetare ISO dhe trajnime për sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në punë sipas legjislacionit shqiptar. Inspektime mbi Konformitetin e ashensoreve, enëve dhe pajisjeve nën presion, impianteve elektrike, makinerive dhe pajisjeve ngritëse për sende dhe njerez. Laborator për realizimin e testeve kimike, mikrobiologjike, testeve mekanike, sigurisë elektrike, analizave të ujit, tokës, ajrit dhe ushqimit.”) **u bë** (“Vlerësimin e konformitetit të implementimit të standarteve nderkombetare ISO. Trajnime dhe kualifikime për standartet nderkombetare ISO. **Trajnime dhe kualifikime profesionale në të gjitha fushat dhe sektorët e aktivitetit.** Trajnime për sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në punë sipas legjislacionit shqiptar. Inspektime mbi Konformitetin e ashensoreve, enëve dhe pajisjeve nën presion, impianteve elektrike dhe hidraulike, makinerive dhe pajisjeve ngritëse për sende dhe njerez. Laborator për realizimin e testeve kimike, mikrobiologjike, testeve mekanike, sigurisë elektrike, analizave të ujit, tokës, ajrit dhe ushqimit.”).” Pra sa më sipër, konstatohet se objekti “...Trajnime dhe kualifikime profesionale në të gjitha fushat dhe sektorët e aktivitetit.”, është shtuar si veprimtari nga ana e subjektit AQScert SHPK në datë 05.10.2020, ndërkohë që Certifikatat e trajnimit të punonjësve për punime në fidanishte të dorëzuar nga operatori ekonomik “Agro – Korani” SHPK, si më sipër, nga 6 punonjës të paraqitur 5 prej tyre disponojnë Certifikatë trajnimi, për trajnimin me temë “Kurs trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”, lëshuar në datë 28.02.2019 nga AQSCERT SHPK. Pra, këto certifikata janë lëshuar përpara se subjekti AQSCERT SHPK të regjistronte në regjistrin tregtar objektin e veprimtarisë “Trajnime dhe kualifikime profesionale në të gjitha fushat dhe sektorët e aktivitetit”, rrjedhimisht ky subjekt në momentin e lëshimit të certifikatave nuk ishte i licensuar për këtë fushë, për sa kohë nuk e ka patur objekt të veprimtarisë së tij.

Pra rezulton se dokumentat e paraqitura për punonjësit me profesion “punime në fidanishte”, në zbatim të pikës 2.2.3 si më sipër cituar nuk përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor për “certifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj”, pasi shoqëria ASQCERT, e cila ka lëshuar Certifikatat e Trajnimit për “Kurs Trajnimi për Shërbime Gjelbërimi”, në momentin e lëshimit të këtyre certifikatave nuk ka patur objekt të veprimtarisë kryerjen e trajnimeve apo kualifikimeve në fusha të caktuara, e rrjedhimisht nuk mund të ishte e licensuar për këtë veprimtari.

Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmeri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar. Përsa më sipër cituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në Certifikatat e Trajnimit, lëshuar nga AQSCERT për “Kurs Trajnimi për Shërbime Gjelbërimi” nuk mund të konsiderohen se përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor për “certifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “AlbGarden” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73052-06-20-2023, me objekt: “Loti 2 “Blerje lule sezonale”” me fond limit 2.083.250 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Agro - Korani” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

